



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-28152/22 dt. 09.02.2022, të pronarëve Nexhat, Haki, Bedri, Adem dhe Abdyl Berisha nga Prishtina dhe investitorit N.N.P. ”Efor Luki”, me seli në Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “E-3.1”, të Ndryshimit dhe Plotësimit Planit Rregullues “Arbëria 3” dhe PZHU-së, në rrugën “Gjergj Balsha” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 04.07.2022, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve Nexhat, Haki, Bedri, Adem dhe Abdyl Berisha nga Prishtina, me investitor N.T.P. ”Efor Luki”, me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810541319, me përfaqësues Llukman Selimi, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-28152/22 dt. 09.02.2022, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesës “A” me etazhitet B+S+P+5ET, ndërtesës “B” me etazhitet B+S+P+5ET dhe ndërtesës “C” me etazhitet B+S+P+4ET të ndërtuara sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-0149493/18 dt. 11.10.2018, dhe Vendimit për plotësim ndryshimin me numër 05 Nr. 351/02-191717/19 dt. 29.08.2019, në kuadër të bllokut urban “E-3.1”, të Ndryshimit dhe Plotësimit Planit Rregullues “Arbëria 3” dhe PZHU-së në Prishtinë konkretisht në parcelën kadastrale nr. 10214-1, ZK Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugët “Gjergj Balsha” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 97, 99, 101/1, 2, 3, 4, 5, 103, 103/1, 2, 3, 4, 5, 105, 105/1, 2, 3, 4, 107, 107/1, 2, 3 në Prishtinë, dhe të njëjtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Arsyetim

Pronarët Nexhat, Haki, Bedri, Adem dhe Abdyl Berisha nga Prishtina dhe investitori N.T.P. "Efor Luki", me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810541319, me përfaqësues Llukman Selimi, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-177289/21 dt. 26.08.2021, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesat shumë banesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesës "A" me etazhitet B+S+P+5ET, ndërtesës "B" me etazhitet B+S+P+5ET dhe ndërtesës "C" me etazhitet B+S+P+4ET, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban "E-3.1", të Ndryshimit dhe Plotësimit Planit Rregullues "Arbëria 3" dhe PZHU-së, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10214-1, ZK Prishtinë, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore Ndërtimore 05 Nr. 351/02-0149493/18 dt. 11.10.2018 dhe Vendimit për plotësim ndryshimin me numër 05 Nr. 351/02-191717/19 dt. 29.08.2019, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-265146/21 dt. 30.12.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimit mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografijë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Avni Hetemi; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Hekuran Buzhala; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Qëndresë Destani; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Gëzim Karaxha; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Gazmend Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Myrvete Mulaj, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga Kompania Gjeodezike e licencuar "Geo-Group" Sh.p.k. me nr. të licencës 47;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e

certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuar-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuessit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-28152/22 DT. 04.07.2022**

Zyrtari,
Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



Drejtori
Arben Sadiki



